

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"7thBLOCK Technology&Communications" SHPK**

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare", ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR", sot me date 25 Shtator 2020 me vullnetin e lire e te plote vendosem te krijojme dhe miratojme Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "7thBLOCK Technology&Communications" Sh.p.k, me kete permbajtje:

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**KAPITULLI I.  
EMRI, FORMA, SELIA DHE KOHËZGJATJA**

Sot me date 25.09.2020 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjistacionit Shqiptar, kryesisht ne ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi, ka perpiluar dhe nenshkruar Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqerise si me poshte vijon

**Neni 1. Data e themelimit dhe Emri.**

- 1.1 Me efekt nga data 25.09.2020, themelohet shoqëria "7thBLOCK Technology&Communications" (në vijim "Shoqëria") e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", i cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortakët e Shoqërisë ("Ortakët), gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.
- 1.3 Në të gjithë dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:
  - 1.3.1 Fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "Shpk";
  - 1.3.2 Numri Unik i Identifikimit të Subjektit NUIS;
  - 1.3.3 Adresa e regjistruar;
  - 1.3.4 Pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedura likuidimi në qoftë se ky rast paraqitet;
  - 1.3.5 Kapitalin e regjistruar të Shoqërisë dhe kapitalin e paguar të Shoqërisë;

**Neni 2. Forma Ligjore.**



2.1 Shoqëria është një entitet shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (“shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”) në përputhje me Ligjin nr. 9910 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji i Shoqërive”).

### **Neni 3. Selia.**

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ibrahim Rugova, Kompleksi Green Park, Kulla 1 Tiranë AL 1001, kati 6, ap. 24. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi Brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 4. Kohëzgjatja.**

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

## **KAPITULLI II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË**


### **Neni 5. Objekti i Veprimtarisë**

5.1 Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni shqiptar, veçanërisht aktivitetet e përcaktuara në pikën 5.2 të këtij neni.

5.2 Shoqëria ka për qëllim ushtrimin e aktiviteteve si më poshtë:

### **Marketing and PR**

- Organizimi i fushatave publicitare, promicionale
- Manaxhimi i marrëdhënie me publikun
- Analiza dhe implementimi i strategjive të marketingut
- Krijim imazhi/brandimi për individë dhe biznese
- Organizim, promovim dhe manaxhim eventesh
- Krijim i spoteve publicitare
- Organizimi i eventeve, trajnimeve dhe konferencave në fushën e marketingut dhe grafikës
- Manaxhim i marrëdhënieve me klientë dhe partnerët
- Krijimi, zhvillimi i strategjive për përdorim efektiv të medias masive përsa i përket hapësirave publicitare në të gjitha llojet e mediave audiovizive
- Krijimi, implementimi i fushatave të marketingut online në social media dhe Google Search Engine
- Krijimi, implementimi i fushatave të marketingut me anë të email, whatsapp, viber





## IT


- Zhvillim i software për të gjitha platformat: web, mobile, desktop që nga faza e analizës, dizajnit, deri tek planifikimi, implementimi, mirëmbajtja dhe testimi
- Konsulencë në fushën e zhvillimit të software në platforma të ndryshme
- Integrimi i sistemeve software të ndryshme
- Analiza, dizajni, planifikimi, implementimi, mirëmbajtja dhe testimi i sistemeve të komunikimit, sigurisë, auditimit, GIS, ERP, HR
- Përmirësim/upgrade i sistemeve ekzistuese
- Analiza, dizajni, zhvillimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve web dhe mobile
- Organizimi i eventeve, trajnimeve dhe konferencave në fushën e informacionit dhe teknologjisë
- Analizë, projektim dhe mirëmbajtje e bazës së të dhënave
- Blerje, shitje pajisjesh hardwerike
- Shërbime suporti në fushë e teknologjisë dhe informacionit
- Shërbime hostimi të software, bazave të dhënave dhe platformave të ndryshme online
- Analizë, projektim, arkitekturë, implementim, mirëmbajtje e sistemeve LAN, WAN
- Analizë, projektim, arkitekturë, implementim, mirëmbajtje e sistemeve të aksesit
- Analizë, projektim, arkitekturë, implementim, mirëmbajtje e sistemeve të kamerave
- Konsulencë për arkitekturë sistemesh
- Instalim, mirëmbajtje serverash fizikë dhe virtual
- Ofrimi, sigurimi, mirëmbajtja e sistemeve të sigurta të komunikimit
- Domain reseller
- Hostim, mirëmbajtje e komunikimeve me email
- Reseller i software antivirus, sistemeve operativ dhe programeve mbështetëse
- Shitja e hardwarëve si kompjuter, laptop, kamera, kamera sigurie, printera, fotokopje dhe komponentë përkatës të tyre
- Shitja e materialeve kancelarike për zyra

## Grafikë

- Dizenjimi, printimi, shpërndarja, shitje e materialeve promocionale
- Dizenjimi, printimi, implementimi, shitje e reklamave indoor dhe outdoor
- Dizenjimi, printimi, shitje e materialeve të personalizuar me logon apo emrin përkatës të klientit

## Të tjera

- Pjesëmarrje në Prokurime Publike
- Konsulencë juridike, ekonomike, financiare në manaxhim dhe zhvillim biznesi, startup-esh
- Studim tregu



- Asistencë dhe konsulencë në regjistrimin dhe mbrojtjen e elementëve të të gjitha formave të pronësisë intelektuale
- Manaxhim, administrim i shitjes dhe blerjes të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme
- Konsulencë ligjore përsa i përket marrëdhënieve të vendosura në fushën e biznesit

## **Neni 6. Ndryshime**

- 6.1 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

## **KAPITULLI III.**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR**

## **Neni 7. Kapitali Themeltar.**

- 7.1 Kapitali i rregjistruar i Shoqërisë është i shprehur në para, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë që do të përdoren si kapital i shoqërisë.

- 7.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 5 (pesë) kuota sipas pjesmarrjes në përqindje për secilin ortak.

## **Neni 8. Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat.**

- 8.1 Ortakët e shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në shoqëri, janë si më poshtë:

- Ilirjan Meçi, lindur më 17.12.1980, shtetas shqiptar, me numër personal I01217085N, lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron një kuotë që përfaqëson 82.380% të kapitalit të Shoqërisë, konkretisht në vlerë nominale 82.380,00 Lekë.
- Algert Kola, lindur më 26.03.1980, shtetas shqiptar, me numër personal I00326069I, lindur në Lushnje dhe banues në Lushnje, me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron një kuotë që përfaqëson 8.809% të kapitalit të Shoqërisë, konkretisht në vlerë nominale 8.809,00 Lekë.
- Erald Greca, lindur më 05.01.1999, shtetas shqiptar, me numër personal J90105090R, lindur në Lushnje dhe banues në Lushnje, me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron një kuotë që përfaqëson 3.964% të kapitalit të Shoqërisë, konkretisht në vlerë nominale 3.964,00 Lekë.



- Zhaklin Bano, lindur më 12.01.1999, shtetas shqiptar, me numër personal J95112081R, lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron një kuotë që përfaqëson 3.083% të kapitalit të Shoqërisë, konkretisht në vlerë nominale 3.083,00 Lekë.
- Lediona Lame, lindur më 16.07.1995, shtetas shqiptar, me numër personal J55716102J, lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, zotëron një kuotë që përfaqëson 1.764% të kapitalit të Shoqërisë, konkretisht në vlerë nominale 1.764,00 Lekë.

#### **Neni 9. Zvogëlimi ose Zmadhimi i kapitalit themeltar.**

- 9.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve me pjesëmarrje 100% te tyre, dhe vendimi merret nga ortakët që zotërojnë të paktën 85% të aksioneve (kuotave).
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
- 9.3 Rritja e kapitalit do të bëhet me kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
- 9.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do të dobësojë pjesën e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përveçse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vendim i cili merret nga ortakët që zotërojnë të paktën 85% të aksioneve (kuotave).


#### **Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve.**

- 10.1 Ortakët janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuota të shoqërisë.
- 10.2 Ortakët e shoqërisë ushtrojnë keto funksione :  
Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë dhe aktet e përgjithshme, vendime për ndryshimin e emertimit të shoqërisë, të cilësisë së saj, të objektit të veprimtarisë, për shtim ortakësh dhe ndryshim administratori. Vendos për rritjen ose pakësimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar të shoqërisë, vendos për ndryshimin e formës së organizimit të shoqërisë. Vendos për mbylljen e veprimtarisë dhe caktimin e likuidatoreve. Të gjitha këto funksione do të kryhen në përputhje me ligjin “Per shoqëritë tregtare” dhe të ligjit “Per regjistrin tregtar”.

- 10.3 Cdo ortak do të ketë të drejta vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve ("Asambleja e Përgjithshme") në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës që zotëron. Cdo ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të shoqërisë, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të shpërndajë fitimet, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky statut, për çdo mosmarrëveshje të detyrueshme ndërmjet ortakëve dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Shoqërive.
- 10.4 Ortakëve do t'u jepen, me kërkesë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentet dhe raportet e shoqërisë.
- 10.5 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i kuotave, transferohen tek çdo zotërues i ri për këto kuota.
- 10.6 Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatësisht në kapitalin e shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).
- 10.7 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të ortakëve të saj.

#### **Neni 11. Transferimi i pjesëve të kapitalit.**

- 11.1 Në rastin kur vendoset nga ana e ortakëve të shiten kuota të shoqërisë, në asnjë rast çmimi i kuotës nuk mund të jetë më pak se 150% e vlerës së saj nominale fillestare.
- 11.2 Vlera nominale e kuotave do mund të ndryshojë çdo vit në varësi të rritjes së të ardhurave dhe vizibilitetit të shoqërisë. Çmimi i kuotave do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në fund të çdo viti kalendarik.
- 11.3 Në 5 vitet e para të veprimtarisë së shoqërisë, çdo ortak nuk mund të blejë më shumë se 5% të kuotave, duke u respektuar rregulli i blerjes së kuotës me së paku 150% të çmimit fillestar.
- 11.4 Pas vitit të pestë të veprimtarisë, kuotat mund të transferohen vetëm ndërmjet ortakëve, me përjashtim të rastit kur ata e miratojnë dhe vendimi merret nga ortakët që zotërojnë të paktën 85% të aksioneve (kuotave). Në këtë rast të fundit, kuotat mund të shiten drejt një blerësi që nuk është ortak në shoqëri.
- 11.5 Pas vitit të 6 (gjashtë) të veprimtarisë së shoqërisë, të gjithë Ortakët kanë të drejtën të barazohen në kuota të shoqërisë, në vlerë dhe në % (përqindje), duke i barazuar ato në masën e 20% secili kundrejt blerjes së kuotave sipas çmimit të momentit të blerjes, i





cili duhet të miratohet gjithësesi nga Asambleja e Ortakëve, por kurrësesi jo më pak se 150% të vlerës së tyre fillestare për çdo kuotë.

- 11.6 Në rast se një ortak do të shesë, transferojë, ose përdorë në mënyra të ndryshme pjesë apo të gjithë kuotën e tij, Ortaku tjetër do të ketë të drejtën e parablerjes kundrejt blerësve të tjerë. Nëse ortaku me të drejtë parablerje do të ketë bërë një ofertë dhe kjo ofertë është refuzuar nga ortaku që shet, atëherë ortaku tjetër do të rishikojë ofertën e bërë dhe do t'i bëjë ortakut që shet një ofertë të dytë. Nëse edhe kjo ofertë e dytë është refuzuar nga ortaku që shet, atëherë ky i fundit nuk do të ketë të drejtë të shesë kuotën tek një blerës tjetër me çmim më të ulët se çmimi i ofruar nga ortaku i preferuar në ofertën e dytë.
- 11.7 Cdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive, me vendim që merret nga ortakët që zotërojnë të paktën 85% të aksioneve (kuotave) dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.


#### **KREU IV. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 12. Kompetencat.**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi drejtues i shoqërisë, i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

##### **Neni 13. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.**

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit.
- 13.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria propozon të shesë apo të dispozojë në mënyrë tjetër aktive, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të të gjithë asetëve të shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bazën e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, që do t'i paraqitet Asamblesë, përveç rastit kur kjo blerje bëhet në bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.
- 13.4 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat financiare të fundit të çertifikuara.



- 13.5 Në rastet e parashikuara në pikate mësipërme 13.3 dhe 13.4, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, përveç rastit kur kjo blerje bëhet në bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të shoqërisë.
- 13.6 Ortakët do të organizojnë takime me administratorët të paktën 1 herë në vit me qëllim vlerësimin e veprimeve të kryera nga Administratorët, diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet që janë objekt i aprovimit nga ana e tyre, përfshirë çështje për të cilat administratorët nuk bien dakord.
- 13.7 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 13.3 dhe 13.6, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### **Neni 14. Mënyra e thirrjes së Mbledhjeve.**

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e shtruarra përpara saj nëpërmjet thirrjes së mbledhjeve ose nëpërmjet konsultave me shkrim.
- 14.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga një prej Administratorëve ose nga çdonjëri prej ortakëve.
- 14.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e shoqërisë, në Shqipëri apo në çdo qytet apo provincë të botës, siç bihet dakord midis ortakëve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e këtyre takimeve si dhe rendi i ditës përkatës i mbledhjeve, u njoftohet ortakëve me postë të regjistruar të paktën 7 ditë përpara mbledhjes. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, kjo e fundit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët bien dakord.
- 14.4 Secili prej ortakëve gëzon të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërive.
- 14.5 Ortakët pranojnë dhe bien dakord me të drejtën për të marrë vendime në lidhje me shoqërinë në formë të shkruar. Rezoluta e propozuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës do t'u dërgohet ortakëve me postë, korrier, telecopy, ose mënyra elektronike të tjera të sigurta. Ortaku/ Ortakët do të marrin vendim për rezolutën përkatëse Brenda një periudhe prej 15 ditësh nga dita që iu është dorëzuar rezoluta. Ortaku/ortakët miratojnë rezolutën duke i kthyer administratorit të shoqërisë një kopje të firmosur të rezolutës me shkrim. Ortakët të cilët nuk janë dakord me rezolutën, shprehin me shkrim kundërshtitë e tyre në lidhje me rezolutën dhe ia kthejnë administratorëve të shoqërisë. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nëse aprovohet me vendim që merret nga ortakët që zotërojnë të paktën 85% të aksioneve (kuotave).






- 14.6 Secili prej ortakëve ka të drejtën të votojë në përputhje me kuotën e zotëruar prej tij në kapital.
- 14.7 Vendimet e mëposhtme do të miratohen me miratimin e ortakëve që zotërojnë të paktën 85% të kapitalit të shoqërisë:
- (i) Pagesa e çdo dividendi në kesh apo natyrë ortakëve të shoqërisë;
  - (ii) Nënshkrimi i marrëveshjeve financiare në lidhje me shoqërinë apo nxjerrja e instrumentave të borxhit nga shoqëria;
  - (iii) Blerja e çfarëdolloj kuote apo interesi tjetër në çdo biznes dhe sipërmarrje;
  - (iv) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë siç është përcaktuar në nenin 7 të këtij Akti Themelimi;
  - (v) Ndryshime dhe amendime të këtij Akti Themelimi dhe
  - (vi) Likuidimi apo shpërndarja e shoqërisë.
- 14.8 Atëherë kur ligji e kërkon këtë, rezolutat e ortakëve duhet të noterizohen nga një noter publik shqiptar. Në rast se këto rezoluta miratohen jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet t'i nënshtrohen kërkesave të ligjit shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Republikën e Shqipërisë (domethënë duhet t'i nënshtrohen procedurës së superlegalizimit apo apostilimit, në varësi të vendit ku lëshohen).
- 14.9 Ortakët do të njoftohen për Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve dhe përmbajtjen e axhendës së takimit.
- 14.10 Administratorët duhet të mbajnë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit të Shoqërive.

#### **Neni 15. Përrjashtimi nga e drejta e votës.**

- 15.1 Një ortak përjashtohet nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- (i) Vlerësimin e veprimtarisë së këtij ortaku;
  - (ii) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - (iii) Ngritjen e një padie kundër tij, nga shoqëria;
  - (iv) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 15.2 Kur ky ortak është i përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi sikundër ortaku që përfaqëson.

### **KREU V. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**


#### **Neni 16. Ortakët e shoqërisë administratorët dhe kompetencat tyre.**



- 16.1 Shoqëria drejtohet nga administratori/Administratorët. Administratorët mund të jenë të çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezidentë në Shqipëri.
- 16.2 Administratorët e shoqërisë do jenë:
- 16.3 Ilirjan Meçi, lindur më 17.12.1980, shtetas Shqipëtar, me kartë identiteti me nr. Personal I1217085N, banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, do të jetë President i Bordit të Administratorëve, ose ndryshe si më poshtë “Administrator i shoqërisë”.
- 16.4 Algert Kola, lindur më 26.03.1980, shtetas Shqipëtar, me kartë identiteti me nr. Personal I00326069I, banues në Lushnje, me zotësi të plotë për të vepruar, do të jetë Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë, ose ndryshe si më poshtë “Administrator i shoqërisë”.
- 16.5 Kohëzgjatja e funksionit të administratorëve është për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë rinovimi kontrate për periudhë të ngjashme kohore, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (domethënë regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit), me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati.
- 16.6 Menjëherë pas pranimi të emërimit të tyre, administrator/administratorët njohin nëse marrëdhënia e tyre me shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi, lidhur me këtë vendimi për heqjen e tyre nëpërmjet një rezolute të ortakëve gjykohet si arsye e ligjshme për shkarkimin e tyre, në përputhje me ligjet përkatëse.
- 16.7 Ortakët kanë të drejtë të shkarkojnë administratorët me shumicë të thjeshtë votash.
- 16.8 Nëse administratorët e shoqërisë nuk arrijnë të bien në një mendim të përbashkët lidhur me mbylljen, përfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve të tjera, çështja do të referohet tek ortakët.
- 16.9 Për aq sa është e lejueshme dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me çdo legjislacion ku aktet e administratorëve kanë fuqi vepruese, administratori/administratorët kanë të drejtën të marrin vendime në lidhje me detyrat e tyre pa qenë fizikisht prezent në Shqipëri ose në ambientet e shoqërisë. Shoqëria u rimbursos administratorit/ administratorëve shpenzimet e arsyeshme gjatë udhëtimeve lidhur me prezencën e detyrueshme të administratorit/ administratorëve në vende që nuk janë Brenda qytetit të rezidencës së administratorit/administratorëve.

## **Neni 17. Kompetencat dhe detyrimet të Ortakëve dhe Administratorëve.**

- 17.1 Kompetencat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të shoqërisë, përfshijnë:
- Thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, për rastet e specifikuar në nenin 13;





- ii. Menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- iii. Përfaqësimin e shoqërisë;
- iv. Kujdesin për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- v. Përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, të bilancit të konsoliduar dhe të raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- vi. Kryerjne regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kur është e nevojshme;
- vii. Raportimin përpara Asamblesë së Përgjithshme e lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- viii. Kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj dhe nga ortakët.

17.2 Administratori/Administratorët mbikqyrin dhe sigurojnë që zyrtarët, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesin e shoqërisë. Administratori/Administratorët duhet të raportojnë tek ortakët në lidhje me personat të cilët emërohen nga ortakët.

#### **Neni 18. Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia.**

18.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Ligjit të Shoqërive, administratorët detyrohen:

- i. Të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- ii. Të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- iii. Të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- iv. Të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
- v. Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

18.2 Administratorët gjatë kryerjes së detyrave të tyre përgjigjen kundrejt shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.

18.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standardeve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të këtij neni, administrator është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë, për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të

vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standardeve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

18.4 Në veçanti, administratori është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet nëqoftëse në kundërshtim me Ligjin e Shoqërive kryen veprimet e mëposhtme:

- i. I kthen ortakëve kontributet;
- ii. I paguan ortakëve interesa apo dividende;
- iii. I shpërndan asete shoqërisë;
- iv. Lejon që shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet të kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet e saj;
- v. Jep hua.

## **KREU VI. AUDITIMI FINANCIAR I SHOQËRISË**

### **Neni 19. Eksperti kontabël i autorizuar.**

19.1 Ortakët mund të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar për të audituar shoqërinë.

19.2 Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

## **KREU VII. AKTIVITETI I SHOQËRISË**

### **Neni 20. Viti ekonomiko-financiar.**

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ditën e parë të muajit dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të shoqërisë.

### **Neni 21. Mbajtja e llogarive.**


21.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

### **Neni 22. Llogaritja dhe Shpërndarja e fitimit.**

22.1 Fitimi i shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, Aktin e Themelimit dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2 Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezervë të detyrueshëm.

22.3 Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:





- i. Asetet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
- ii. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.
- iii. Vetëm mbasi ka shlyer të gjitha borxhet dhe detyrimet ndaj ortakëve.

22.4 Administratorët lëshojnë një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 22.3 më sipër. Ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund të lëshojnë këtë çertifikatë.

22.5 Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese.

## **KREU VIII. MODIFIKIMI I FORMËS LIGJORE**

### **Neni 23. Modifikimi i formës ligjore.**

23.1 Forma ligjore e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat respektive në legjislacionin shqiptar.

23.2 Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

### **Neni 24. Prishja e shoqërisë.**

24.1 Shoqëria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:

- i. Si pasojë e përfundimit të kohëzgjatjes për të cilën ishte themeluar;
- ii. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- iii. Hapjen e një procedure falimentimi;
- iv. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- v. Me vendim gjykate;
- vi. Për arsye të tjera të parashikuara nga ortakët në çdo kohë.

24.2 Administratori/Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rast se prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ia njofton vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

## **KREU IX. TË NDRYSHME**



**Neni 25. Largimi i ortakut.**


25.1 Largimi ose përjashtimi i një ortaku, si dhe pasojat që kjo sjell, do të rregullohen nga nenet 101, 102, 103 të Ligjit të Shoqërive.


**Neni 26. Të tjera.**

26.1 Cdo çështje tjetër, e cila nuk është e përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

**NËNSHKRIMI I THEMELUESVE/ ORTAKËVE**

Algert Kola 

Shakir Bero 

Erzeld Greca 

Robert Kadiu 

Lestiona Lome 